



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AGJENCISË KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të AKKVP kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtoresha Ekzekutive është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtoresha Ekzekutive është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtoresha Ekzekutive është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Agjencisë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Agjencisë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Agjencisë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Agjencisë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fusha që kërkon më shumë fokus ka të bëjë me menaxhimin e detyrimeve kontigjente për shkak të mbivlerësimit të tyre. Në kontekst të shpenzimeve, kërkohet fokus te fusha e pagave dhe mëditjeve, përkatësisht me autorizimet dhe aprovimin e pagesave të zyrtarëve për punët e kryera jashtë orarit të rregullt, dokumentimin e procedurave të rekrutimit si dhe mbulimin e pozitave me vendime për transfere. Po ashtu, kërkohet vëmendje e shtuar lidhur me zbatimin e plotë të monitorimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm përmes realizimit të auditimeve të brendshme.

Ky raport ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime, prej tyre një (1) është pjesërisht i përsëritur si dhe pesë (5) janë rekomandime të reja.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Kontrollat e brendshme në raportimin financiar

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

Çështja A1 - Mosregjistrimi i të hyrave nga Skema Vullnetare e Qirasë në periudhën përkatëse

Gjetja

Rregullorja (QRK) Nr.19/2023 për rregullat dhe procedurat rreth administrimit të pronave dhe zbatimit të skemës vullnetare të qirasë, neni 13.2 përcakton se Agjencia në emër të shpenzimeve të shërbimeve i mban 10% nga shuma e qirasë për të gjitha kontratat. Rregulla Financiare 03/2010 për të hyrat, përcakton formën e regjistrimit të të hyrave në SIMFK, ndërsa Rregullorja Nr 01/2017 për raportimin vjetor financiar nga organizatat buxhetore, përcakton se raportimi për pranimet dhe pagesat bëhet për vitin përkatës fiskal.

Kemi evidentuar se gjatë vitit 2024, AKKVP ka realizuar të hyra në vlerë 1,653€ nga administrimi i pronave sipas Skemës Vullnetare të Qirasë. Këto mjete janë mbajtur brenda llogarive të depozitave dhe nuk janë klasifikuar si të hyra jo tatimore në pasqyrat financiare të vitit 2024. Vetëm në vitin 2025, Agjencia ka iniciuar procedurën për njohjen dhe regjistrimin e këtyre të hyrave përmes Thesarit, ndonëse ato i përkasin periudhës fiskale të vitit 2024.

Sipas sqarimit të AKKVP, mos regjistrimi i të hyrave në vitin 2024 është rezultat i rifillimit të Skemës së Qirasë pas një periudhe pezullimi dhe pranimit të pagesave të para vetëm në prill të vitit 2024. Pas konsultimit me Thesarin, duke marrë parasysh numrin e vogël të pronave të dhëna me qira dhe vlerën e ulët të të hyrave, Agjencia ka vendosur që regjistrimi i 10% të të hyrave t'i bëhet njëherësh në vitin 2025.

Ndikimi

Mos regjistrimi i të hyrave që i takojnë AKKVP nga Skema Vullnetare e Qirasë ka rezultuar në nënvlerësim të të hyrave jo tatimore duke cenuar parimin e njohjes së të hyrave sipas periudhës së realizimit dhe njëkohësisht në mbivlerësim të shumës së depozitave në pasqyrat financiare të vitit 2024. Si rezultat, pasqyrat financiare vjetore nuk reflektojnë gjendjen reale financiare të Agjencisë.

Rekomandimi A1

Drejtoesha Ekzekutive duhet të sigurojë që të hyrat që i takojnë Agjencisë sipas rregullores të regjistrohen dhe të raportohen brenda periudhës përkatëse fiskale. Po ashtu, duhet të forcohen kontrollat e brendshme për identifikimin dhe regjistrimin e saktë të të hyrave në kohën e duhur.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Vlera e buxhetit final për paga dhe mëditje dhe realizimi i tij i shpalosur në PFV për vitin 2024 ishte 1,246,225€.

Çështja A2 - Mungesa e autorizimeve paraprake dhe dëshmive për vijueshmëri për orët e punëve jashtë orarit të rregullt

Gjetja Rregullorja Nr. 07/2023 për kompensimin e punës jashtë orarit, neni 7.2 ndër të tjera përcakton se angazhimi për orë jashtë orarit duhet të miratohet paraprakisht nga udhëheqësi më i lartë i institucionit. Po ashtu, Rregullorja (QRK) Nr.10/2022 si dhe Rregullorja e re (QRK) Nr.04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë zyrtarëve publik, neni 17.2 dhe 17.3 përcaktojnë se vijueshmëria në punë e zyrtarit publik evidentohet përmes regjistrimit në sistemin elektronik ose përmes regjistrimit në librat evidentues. Tutje, neni 5 i Rregullorës (QRK) Nr. 09/2017 për punën e Bordit Mbikqyrës, ndër të tjera përcakton se Bordi mbikqyrë organizimet administrative, nevojat operacionale dhe financiare si dhe mbikëqyr përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të Drejtorit. Po ashtu, Ligji Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, neni 5.8 përcakton se zyrtari duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, i mundshëm apo në dukje.

Kemi evidentuar mangësi në procesin e dokumentimit të punëve të realizuara jashtë orarit të rregullt. Mangësitë kanë të bëjnë me kompensimin dhe autorizimet paraprake nga udhëheqësi më i lartë i institucionit.

Nga mostrat e testuara, në shtatë (7) raste është bërë kompensimi për punë jashtë orarit në vlerë prej 1,398€ pa dëshmi për prezencë ose vijueshmëri të punës së kryer. Ndërsa, në një rast tjetër, është vërejtur se Zyrtari Kryesor Administrativ ka aprovuar kompensimin për punë jashtë orarit në dobi të vetes.

Për më tepër, për këto raste mungonin autorizimet paraprake për punën jashtë orarit.

Kjo gjendje ishte rezultat i mos zbatimit të plotë i kërkesave ligjore dhe neglizhencës në zbatimin e kontrolleve të brendshme.

Ndikimi Këto mangësi rrisin rrezikun për shpenzime të paarsyetuara dhe mund të çojnë në keqpërdorim të mjeteve publike.

Rekomandimi A2 Drejtoresha Ekzekutive duhet të sigurohet që angazhimi i personelit në orë jashtë orarit të bëhet vetëm pas marrjes së aprovimit paraprak me shkrim nga udhëheqësi më i lartë i institucionit dhe të shoqërohet me dëshmi të plota për vijueshmëri dhe përmbushje të detyrave. Gjithashtu, të forcohen kontrollet e brendshme për të siguruar zbatimin e saktë të rregulloreve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mungesa e dokumentacionit mbështetës në dosjen e rekrutimit

Gjetja	Rregullorja (QRK) NR. 15/2023 për procedurën e pranimi në shërbimin civil, neni 9, ndër të tjera përcakton se komisioni i pranimi përzgjedhë pyetjet e testit me shkrim duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim, bazuar në të cilin bëhet vlerësimi i kandidatëve. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të rekrutimit për pozitën Udhëheqës të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, nuk na janë siguruar të gjitha dokumentet e procedurës, përkatësisht dëshmitë për pyetjet e përzgjedhura të testimit me shkrim si dhe testi me shkrim i administruar për kandidatët. Si rezultat, nuk ishin në gjendje të vlerësonim nëse ishin zbatuar kërkesat e rregullores për vlerësimin e testimit me shkrim. Kjo gjendje ishte si rezultat i mungesës së njohurive si dhe mos zbatimit të plotë të kërkesave të kontrollit të brendshëm për dokumentimin e plotë gjatë dhe pas përfundimit të procesit të rekrutimit.
Ndikimi	Mungesa e dokumentacionit e bën të pamundur vërtetimin e korrektesisë dhe transparencës së procesit të rekrutimit, çka rrezikon besueshmërinë e procesit dhe rrit mundësinë për parregullsi gjatë përzgjedhjes së stafit.
Rekomandimi A3	Drejtoresha Ekzekutive të përforcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm për të siguruar që çdo fazë e procesit të rekrutimit të dokumentohet dhe të ruhet në dosjen përkatëse, duke respektuar kriteret ligjore dhe standardet e transparencës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja C1 - Transferet e përkohëshme të nëpunësve në pozita për kategori më të larta**

Gjetja	Neni 63.1 i Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përcakton se nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori prej gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) muaj gjatë dy (2) vjetëve. Janë identifikuar katër raste (4) raste të transferimeve të përkohshme në pozita të cilat janë të kategorive më të larta se ato paraprake. Për më tepër, vendimet për tre (3) nga këto transfere tejkalojnë afatet e përcaktuara ligjore. Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës është miratuar në prill të vitit 2024, mirëpo organizata buxhetore ende nuk ka arritur të sistemojë të gjitha pozitat në përputhje me dispozitat e saj.
Ndikimi	Mbulimi i pozitave përmes transfereve të përkohshme në pozita më të larta, përveçse nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi, paraqet rrezik që këto pozita të mbahen nga persona që mund të mos i përmbushin kriteret e kërkuara për pozitat përkatëse.
Rekomandimi C1	Drejtoresha Ekzekutive duhet të sigurojë zhvillimin e procedurave përkatëse për plotësimin e pozitave me personel të rregullt që aktualisht mbulohen me vendime për transfere të përkohshme, në përputhje me

rregulloren e re të miratuar për organizimin e brendshëm dhe
sistematizimin e vendeve të punës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Detyrimet kontigjente

Vlera e detyrimeve kontigjente e shpalosur në PFV ishte prej 98,732€.

Çështja A4 - Mbivlerësim i detyrimeve kontigjente

Gjetja

Sipas nenit 18 të Rregullores nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, “Organizatrat buxhetore në harmoni me LMFPP-në raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente”.

Kemi identifikuar se detyrimet kontigjente të prezantuara në PFV ishin mbivlerësuar për 12,322€, ngase nuk janë siguruar dëshmi që mbështesin se rastet janë ende aktive, si rezultat nuk ekziston më një ekspozim financiar real.

Përkatësisht, në dy (2) prej këtyre rasteve në vlerë 9,264€, çështjet janë përmbyllur nga Gjykata Supreme dhe Gjykata Kushtetuese duke refuzuar kërkesat e paditësve. Po ashtu, në një (1) rast tjetër në vlerë 3,058€, nuk na është siguruar ndonjë dokumentacion që paraqet bazë të mjaftueshme për mundësinë e krijimit të një detyrimi financiar ndaj institucionit për të justifikuar përfshirjen e lëndës në regjistrin e detyrimeve kontingjente.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mangësive në funksionimin e kontrolleve të brendshme gjatë procedimit të lëndëve për raportimin e detyrimeve kontingjente në PFV.

Ndikimi

Prezantimi i regjistrit të detyrimeve kontigjente në mungesë të dëshmive mbështetëse ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PFV të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me shpalosjen e këtyre detyrimeve, njëherit ndikon në planifikim jo të mirë të buxhetit për vitin vijues.

Rekomandimi A4

Drejtoresha Ekzekutive duhet të sigurojë se zbatohen kontrollet e brendshme gjatë raportimit të detyrimeve kontingjente në PFV, mbështetur me dokumentacion të mjaftueshëm dhe përkatës. Për çdo rast të përfshirë duhet të vërtetohet se është ende aktiv dhe përbën një rrezik të mundshëm financiar për institucionin. Gjithashtu, regjistri duhet të përditësohet rregullisht në përputhje me zhvillimet procedurale të rasteve gjyqësore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.4 Funksioni i auditimit të brendshëm

Funksioni i auditimit të brendshëm është i themeluar me Statutin e Njesisë së Auditimit (NjAB). Kjo njësi operon me një (1) auditor (drejtor) i rekrutuar gjatë vitit 2024. NjAB nuk kishte përgatitur planin strategjik e as planin vjetor të auditimit. Ka realizuar një raport lidhur me përcjelljen e implementimit të rekomandimeve të dhëna në vitin 2023 kanë rezultuar me pesë (5) rekomandime të pa zbatuara, si dhe kishte përgatitur një raport për Komitetin e auditimit.

Çështja A5 - Mangësi në funksionimin e NjAB

Gjetja

Sipas Udhëzimit Administrativ MF-Nr. 01/2019 për Funksionimin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, nenit 11, njësitë e auditimit të brendshëm janë të obliguara të: Hartojnë një plan strategjik dhe një plan vjetor të auditimit, të bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe objektivat organizative; Realizojnë auditime sipas planit të miratuar; Përgatisin dhe dorëzojnë raporte të rregullta te Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditimin e Brendshëm (NjQHAB).

NjAB nuk ka hartuar planin strategjik të auditimit dhe as planin vjetor të punës. Rrjedhimisht nuk kishte kryer ndonjë raport të auditimit që mbulon vitin 2024. Gjatë vitit është realizuar vetëm një angazhim i auditimit të brendshëm, i cili ka pasur për qëllim përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i vitit paraprak (2023) si dhe një raport për Komitetin e Auditimit.

Për më tepër, NjAB nuk ka kryer raportimin periodik në NjQHAB, siç kërkohet me kornizën ligjore dhe udhëzimet përkatëse që rregullojnë funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mungesës së kapaciteteve të mjaftueshme brenda NjAB, për shkak se operon vetëm me një auditor të rekrutuar gjatë vitit 2024. Për më tepër, mos angazhimi i duhur menaxherial për mbështetjen dhe fuqizimin e NjAB ka ndikuar në mos përmbushjen e detyrimeve të planifikimit dhe raportimit, si dhe në mungesën e një qasje të strukturuar për realizimin efektiv të funksionit të auditimit të brendshëm.

Ndikimi

Mungesa e planifikimit strategjik dhe vjetor të auditimit të brendshëm kufizon aftësinë e NjAB për të identifikuar dhe adresuar rreziqet kryesore të institucionit dhe për të ofruar siguri të mjaftueshme mbi funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme. Mungesa e raporteve të auditimit, së bashku me mos raportimin në NjQHAB, dobëson mbikëqyrjen menaxheriale duke ndikuar negativisht në përmirësimin e proceseve të brendshme dhe menaxhimin efikas të burimeve.

Rekomandimi A5

Drejtoresha Ekzekutive të sigurojë funksionalizimin e plotë të NjAB në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet profesionale për të siguruar mbikëqyrjen e duhur të proceseve lidhur me kontrollet e brendshme. Në të kundërtën të shqyrtohet mundësia e alternativave tjera për sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	2,613,969	2,369,947	2,245,976	2,020,804	2,178,948
Grante Qeveritare - Buxheti	2,613,969	2,369,947	2,245,976	2,020,804	2,178,948

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 244,022€. Kjo rënie është si rezultat i shkurtimeve buxhetore me vendim qeveritar.

Në vitin 2024 AKKVP ka shpenzuar 95% të buxhetit përfundimtar ose 2,245,976€, me një përmirësim prej 11% në krahasim me vitin paraprak. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	2,613,969	2,369,947	2,245,976	2,020,804	2,178,948
Pagat dhe mëditjet	1,490,247	1,246,225	1,246,225	1,202,116	1,071,048
Mallrat dhe shërbimet	795,199	795,199	746,667	744,730	782,339
Komunalitë	48,523	48,523	38,314	37,178	38,131
Investimet Kapitale	280,000	280,000	214,770	36,780	287,430


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë ekonomike të buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 244,022€ si rezultat i vendimit të Qeverisë për kursime. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 100%.

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë shpenzimet komunale) ishte i njëjtë me buxhetin fillestar. Realizimi i buxhetit ishte 93%.

Po ashtu, buxheti final për investime kapitale ishte i njëjtë me buxhetin fillestar. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 77%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



AKKVP nuk kishte të hyra të palnifikaura për vitin 2024. Ndërsa të hyrat e realizuara prej 9,666€ kishin të bënin me shitjen e pasurive publike.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	0	0	9,666		
Të hyrat jo tatimore	0	0	9,666		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV të vitit 2023 ka rezultuar me një rekomandim. AKKVP kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, ky rekomandim ishte në proces të zbatimit.

Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pagat dhe mëditjet	Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë duhet të sigurojë, se hartohet dhe aprovohet rregullorja për organizim të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës me qëllim të mbarëvajtjes së institucionit dhe zhvillimin e aktiviteteve normale të të gjitha njësive. Po ashtu, duhet të sigurojë që respektohen kërkesat ligjore në lidhje me plotësimet e pozitive (zëvendësimeve) dhe transferimet e përkohshme të stafit.	AKKVP ka hartuar rregulloren e re për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, përmes së cilës ka filluar sistemimi i zyrtarëve që ishin me vendime për ushtrues detyre dhe transfere të përkohëshme. Mirëpo, edhe gjatë vitit 2024 kemi evidentuar mangësi të pjesa e vendimeve për transferet e përkohëshme të zyrtarëve.	Pjesërisht i zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Ylber Sadiku, Udhëheqës i ekipit



Refiqe Morina, Anëtare e ekipit




Hysen Restelica, Anëtar i ekipit



Lumturije Sopi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

REPUBLIKA E KOSOVës / REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT / NATIONAL AUDIT OFFICE			
Duke marrë në konsideratim / Having taken into consideration			
20.06.25			
Pro. Jedin.	Pro. Jedin.	Pro. Jedin.	Pro. Jedin.
05	47	1091	1

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Nga: Afërdita Beka Arifaj, Drejtore e Sekretarise Ekzekutive AKKV
Agencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës



Data: 20 qershor 2025, Prishtinë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.